



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosova**  
*Qeveria –Vlada-Government*  
**Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health**

Departamenti Shëndetësor i Burgjeve

## **Rregulloret dhe Format për Metadon në Burgje**

### **Përmbajtja:**

<b>1. Kriteret për përpilimin e listës për hyrje në program të metadonit në burgje për të burgosurit .....</b>	<b>2</b>
I. Të përgjithshme .....	2
II. Të veçanta – kriteret dhe përparësitë për hyrje në program .....	2
III. Të veçanta – kriteret për dalje nga programi .....	3
<b>2. Mënyra e dhënies së Metadonit në burgje.....</b>	<b>3</b>
I. Të përgjithshme .....	3
II. Të veçanta – Mënyra e dhënies së Metadonit .....	3
III. Të veçanta – Mënyra e evidentimit.....	4
<b>3. Mënyra e vazhimit me Program të Metadonit për personat që vijnë nga programi i metadonit nga jashtë në burgje si të burgosur.....</b>	<b>4</b>
I. Të përgjithshme .....	4
II. Të veçanta – Mënyra e veprimit në institucione të ndryshme në burgje.....	5
<b>4. Mënyra e vazhimit me Program të Metadonit në institucionët e shëndetit publik / privat për të burgosurit që dalin nga burgju .....</b>	<b>6</b>
I. Të përgjithshme .....	6
II. Të veçanta – Detyrat e stafit shëndetësor për informim dhe vazhdim të trajtimit .....	6
<b>RREGULLA DHE DEKLARATA PËR KLIENTË NË PROGRAMIN E MMT-se .....</b>	<b>7</b>

Tetor 2017, në Prishtinë

## 1. Kriteret për përpilimin e listës për hyrje në program të metadonit në burgje për të burgosurit

Në burgjet e Kosovës dhënia e Metadonit bazohet në Rregulloren e përgjithshme për mënyrën e dhënies së Metadonit të aprovuar nga Komisioni Profesional i Ministrisë së Shëndetësisë, të datës 27.03.2012 me numër 05-1609.

### I. Të përgjithshme

1. Hyrja në Program të Metadonit është në baza vullnetare, jo i domosdoshëm dhe jo i obligueshëm qoftë për të burgosurin qoftë për institucionin.
2. Institucioni nuk është i obliguar që secilin person që plotëson kriteret apo benë kërkesë ta fus në program për shkak të kufizimeve që i ka projekti.
3. Stafit mjekësor është i obliguar që të informoj të burgosurin që ka përdorur droge për ekzistimin e programit të metadonit.
4. Evidentimi i personave të përshtatshëm për hyrje në program të metadonit bazohet në dosjen mjekësore, formën mjekësore në pranim ku i burgosuri pyetet për drogat, kërkesën e vetë të të burgosurit, sugjerimet e pjesëtareve të stafit dhe fletë rekomandimi nga sektori publik se personi gjendet në program të metadonit jashtë.
5. Në secilin burg formohet ekipi multidisiplinar për shqyrtimin e rasteve dhe eventualisht hartimin e listës për hyrje në program të metadonit, i cili njëkohësisht rekomandon hyrjen në program.
6. Komisioni ka përbërje nga:
  - Mjeku përgjegjës i institucionit
  - Mjeku Kujdestarë në Institucion
  - Psikiatër të institucionit
  - Psikologu i institucionit
  - Një infermiere
7. Udhëheqësi i NJSHB, shikon respektimin e rregullave dhe kriterëve për secilin rast dhe aprovon ose jo futjen në program të secilit duke u bazuar në kriteret e programit.
8. Secili i burgosur që hynë në program duhet të nënshkruaj kontratën me panelin.

### II. Të veçanta – kriteret dhe përparësitë për hyrje në program

1. Të gjithë personat që dëshirojnë të hynë në program, shprehin gatishmëri me kërkesë individuale, rekomandime të përshtatshme profesionale dhe që janë në gjendje ta kuptojnë programin, ose ekipi multidisiplinar mendon se ka nevojë.
2. Gratë shtatzëna dhe me fëmijë në gji.
3. Personat që vijnë me fletë rekomandime dhe me dëshmi se janë në program të metadonit në institucionet publike jashtë burgjeve.
4. Personat që kanë përdorur heroinë në mënyrë IV (intra venoz) për një periudhë më shumë se 5 vite.
5. Në raste të tjera prioritet kanë ata persona që e kanë përdorur drogën me gjatë se të tjerët.

6. Personat qe kanë sëmundje të tjera infektive dhe psikiatrike (komorbiditeti).
7. Personat qe kanë mase për trajtim të detyrueshëm me Metadon nga Gjykata.

### III. Të veçanta – kriteret për dalje nga programi

1. Të gjithë personat qe mendojnë se nuk kanë nevojë me për vazhdimin e programit dhe qe dëshirojnë vullnetarisht të dalin nga programi.
2. Të gjithë personat qe përfundojnë dënimin dhe u lëshohet fletë rekomandimi për vazhdim në institucionet e kujdesit publik.
3. Të gjithë personat qe paneli konsideron se duhet të ju ndërpritet programi për shkak se nuk është duke u respektuar nga klienti, nuk ka dobi shëndetësore e as farmaceutike vazhdimi i mëtejme si dhe personat qe keqpërdorin metadonin.
4. Nëse Paneli konsideron se Klienti nuk është duke i rrespektuar rregullat e programit, ka probleme shëndetësore si dhe abuzim me anksiolitik dhe benzodiazepina, atëherë mund të largohet nga programi qe është në Metadon.
5. Në rast se ka alergji ose nuk i bene dobi metadoni, atëherë konsiderohen substancat e tjera të mbajtës si opsionale.

## 2. Mënyra e dhënies së Metadonit në burgje

### I. Të përgjithshme

1. Metadoni jepet falas në burgje dhe jashtë burgjeve për të gjithë personat qe hyjnë në program të Metadonit.
2. Metadoni transportohet në burgje nga personat e autorizuar nga MSh me frekuence sipas marrëveshjes.
3. Pranim dorëzimi behet me shkrim dhe personi qe pranon metadonin mbanë evidence të përditshme lidhur me hyrjet, shpenzimet, stokun dhe planin për mbulim të ditëve në vijim.
4. Metadoni ruhet në rafte të mbyllura me dry të cilin e kanë vetëm personat e autorizuar (ata qe bëjnë shpërndarjen dhe ata qe do të zëvendësojnë ata në rast të mungesës së tyre).
5. Nxjerrja e metadonit nga rafti behet vetëm për nevojat ditore dhe vetëm për pacientët e parapare në listën e aprovuar nga Paneli i NjShB-së.

### II. Të veçanta – Mënyra e dhënies së Metadonit

1. Metadoni në burgje u jepet të burgosurve për çdo ditë në mëngjes me doze të caktuara.
2. Dozimi është individual dhe përcaktohet nga psikiatri i autorizuar nga paneli.
3. Metadoni jepet në vendin me të përshtatshëm për klientin dhe institucionin, përcaktuar nga paneli për rastet veç e veç.

4. Të burgosurit që janë me terapi të metadonit dhe që kanë pushime jashtë burgut, në shtëpi, fundjavë, përcjellje humanitare etj, marrin me vetë sasinë e metadonit për ditët sa nuk do të jetë prezent në institucion, vlerësimi bëhet sipas rastit.
5. Ndërrimi i dozës bëhet nga ana e psikiatrit të autorizuar nga paneli.
6. Paneli përpilon rregullore të brendshme për specifikat e punës dhe ndarjen e detyrave sipas përkatësisë profesionale dhe hierarkike të institucionit.
7. Gëlltitja e Metadonit bëhet në praninë e personelit mjekësor dhe atij të sigurisë.
8. Metadoni nuk i jepet askujt me dhunë apo me kushtëzime.
9. “Ad hock”, sipas mendimit të lire të infermierit që jep apo në konsultim me mjekun dhe psikiatrin bëhen testet e drogave për personat që janë në program të metadonit. Këto testet bëhen edhe në mënyrë të rregullt. Shpeshhtësinë e bërjes së testeve të rregullta e përcakton paneli.
10. Në fillim, testet u bëhen të gjithë të burgosurve që kanë pasur vizita në shtëpi dhe që janë në program të metadonit. Varësisht nga gjetjet dhe sjelljet e tyre, testimi vazhdohet apo rrallohet sipas vlerësimit të panelit.
11. Testi i urinës për droga bëhet nga laboranti apo infermieri i institucionit.

### III. Të veçanta – Mënyra e evidentimit

1. Për secilin person që hyn në program të metadonit duhet të lëshohet një vendim me shkrim.
2. Ky fakt evidentohet në dosje mjekësore dhe në listën individuale që duhet të jetë për metadon.
3. Evidenca mbi shpenzimet e Metadonit mbahet në libër të veçantë, në listën e veçantë dhe në mënyrë elektronike në formularin ku përcaktohet sasia e shpenzuar.
4. Evidenca duhet të jetë striktë dhe e përditshme pas çdo shpërndarje.
5. Raportimi mbi shpenzimet bëhet në mënyrë periodike, të përcaktuara më parë.
6. Raportimi i bëhet në Drejtorinë e DSHB, në MSH
7. Porosia për metadon për ditët në vijim bëhet me kohe dhe nuk guxon që askush të mbetet pa marrë metadon.

## 3. Mënyra e vazhdimit me Program të Metadonit për personat që vijnë nga programi i metadonit nga jashtë në burgje si të burgosur

Në rast se një person ka hyrë në program të Metadonit në burgje, qoftë si rast i verifikuar aty, qoftë si rast i ardhur nga jashtë, pas lirimimit ky person duhet të vazhdojë programin e metadonit në institucionet publike.

### I. Të përgjithshme

1. Për rastet që dihet se duhet të shkojnë për vuajtje të dënimit, Institucioni publik ku personi është në trajtim duhet të lëshoj fletë rekomandim për vazhdim të trajtimit edhe në burgje.
2. Nëse personi është arrestuar pa e planifikuar, ai duhet të dije se në burgje duhet të informoj stafin mjekësor se është në trajtim me metadon.
3. Pas kësaj, menaxhmenti shëndetësor në kohën më të shkurtër të mundshme, duhet të siguroj informatën nga institucioni ku personi ka qenë në program të metadonit lidhur me të gjitha specifikat.
4. Me verifikimin e informatës, informohet paneli dhe personi menjëherë vazhdon trajtimin me metadon me dozën e mëparshme që ka qenë në trajtim.
5. Nëse burgjet nuk kanë sasi të mjaftueshme të metadonit për këto raste, atëherë bëhet huazimi nga institucionin prej nga ka ardhur personi që të bëhet kompensimi me sasinë e metadonit të nevojshëm.

## II. Të veçanta – Mënyra e veprimit në institucione të ndryshme në burgje

1. Metadoni aplikohet në burgje.
2. Tërë infrastruktura është e gatshme në katër burgje, stafi, protokollet, vendi i ruajtjes, dhe mënyra e menaxhimit të Metadonit.
3. Vetëm personat e vendosur në këto burgje mund të hyjnë në program pas vlerësimit nga paneli.
4. Personat që gjenden në Qendra të paraburgimit dhe janë të denjë për program të metadonit, propozohen nga stafi mjekësor i institucionit, nëse nuk ka pengesa të tjera, ky person dërgohet në njërin prej këtyre qendrave dhe i nënshtrohet vlerësimit të panelit.
5. Personat që vijnë në Qendrën e paraburgimit dhe janë nën trajtim me Metadon, pas konfirmimit të informatave të cekura më lartë, futën në program të Metadonit aty ku janë duke iu dërguar fillimisht sasia e Metadonit në QP e mandej krijohen kushtet sa më shpejt që të jetë e mundur për zhvendosjen e tyre për në njërin nga qendrat korrektuese.
6. Nëse personi del nga burgju menjëherë, informohet institucioni prej nga ka ardhur.
7. Nëse personi dërgohet në ndonjërin nga qendrat korrektuese, atëherë vazhdon programi i trajtimit siç ka qenë më parë në institucionin publik dhe në qendrën e paraburgimit.
8. Këta persona vazhdojnë programin e Metadonit sikur të gjithë personat e tjerë që janë futur në program në burgje.
9. Lidhur me mënyrën e menaxhimit të metadonit për këta persona do të ketë marrëveshje për secilin rast veç e veç.

## 4. Mënyra e vazhimit me Program të Metadonit në institucionët e shëndetit publik / privat për të burgosurit që dalin nga burgu

Në burgjet e Kosovës dhënia e Metadonit bazohet në Rregulloren e përgjithshme për mënyrën e dhënies së Metadonit të aprovuar nga Komisioni Profesional i Ministrisë së Shëndetësisë, të datës 27.03.2012 me numër 05-1609.

Kriteret e futjes në listë për personat që janë në program të Metadonit në sektorin publik janë unike edhe për burgje.

Në rast se një person ka hyrë në program të Metadonit në burgje, qoftë si rast i verifikuar aty, qoftë si rast i ardhur nga jashtë, pas lirimit ky person duhet të vazhdojë programin e metadonit në institucionet publike.

### I. Të përgjithshme

1. Për raste që dihet se do të përfundojnë vuajtjen e dënimit, NjShB ku personi është në trajtim duhet të lëshoj fletë rekomandim për vazhdim të trajtimit të tij edhe jashtë burgjeve.
2. Fletë rekomandimi duhet të përmbajë të gjitha specifikat lidhur me trajtimin në burgje.
3. Nëse personi është liruar pa paralajmërim, ai duhet të jetë i informuar se kur të del jashtë mund të shkojë në institucionin me të afërt adekuat për vazhdim të tretmanit.
4. Institucioni publik adekuat ku ky person është lajmëruar, ka mundësi të kontaktoj me menaxhmentin shëndetësor të burgjeve dhe të verifikoj të dhënat.

### II. Të veçanta – Detyrat e stafit shëndetësor për informim dhe vazhdim të trajtimit

1. Stafit mjekësor në të dyja burgjet por edhe në institucionet e tjera korrektuese duhet të jetë mirë i informuar lidhur me mundësinë e vazhimit të programit të metadonit pas lirimit.
2. Secilit person që është në program duhet ti sqarohet kjo mundësi.
3. Menaxhmenti shëndetësor i burgjeve dhe institucionet relevante publike që merren me programin e metadonit duhet të kenë kontakte zyrtare të vazhdueshme në funksion të vazhimit të programit të metadonit për të gjithë të burgosurit që lirohen apo dalin nga burgu.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosova**  
*Qeveria –Vlada-Government*  
***Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health***

Departamenti Shëndetësor i Burgjeve

**RREGULLA DHE DEKLARATA PËR KLIENTË NË PROGRAMIN E MMT-se**

Respektimi i rregullave të mëposhtme është i obligueshëm:

- I. Për të përfituar dhe për t'u regjistruar në MMT është e obligueshme të keni vullnet dhe të pranoni programin (marrja e metadonit nuk mund të jetë anonime por është konfidenciale, që do të thotë se emrat e juaj ruhen nga stafi shëndetësorë dhe Institucioni Korrektues dhe nuk i jepen asnjë burimi tjetër).
- II. Menjëherë pas gëlltitjes së metadonit, nëse kërkohet nga stafi, duhet të shqiptoni se paku pesë fjalë.
- III. Marrja e Metadonit bëhet nga infermieret dhe nën vëzhgimin e oficerit korrektues.
- IV. Doza përcaktohet nga psikiatri, anëtar i panelit të autorizuar dhe duhet të respektohet.
- V. Metadoni merret çdo ditë në orar të caktuar. Mos përgjigja në kohe të caktuar përjashton atë ditë marrjen e metadonit përpos në raste të arsyeshme dhe në pamundësi objektive për shkak të rregullave të institucionit.
- VI. Është e obligueshme që klienti të nënshtrohet testimit në opioide dhe metadon test në çfarëdo kohe kur kërkohet nga stafi shëndetësor. Gjatë marrjes së mostrës së urinës është e obligueshme që të jetë prezent një anëtar i stafit të shëndetësor. Në rast se klienti nuk i nënshtrohet testimit të kërkuar, atëherë nuk jepet doza e caktuar e metadonit.

- VII. Ndalohen sjelljet e dhunshme, kërcënimet, shantazhet dhe ofendimet ndaj stafit dhe të tjerëve. Në rast to mos respektimit të këtyre rregullave, stafi i shëndetësor është i obliguar që menjëherë të lajmërojë personin e autorizuar që të merren masa adekuatë konform rregullave të institucionit dhe rregulloreve për Metadon.
- VIII. Ankesat mund t'i drejtoni me shkrim të Udhëheqësit të NJSHB-së, apo Udhëheqësit të DSHB, në MSH.

### **DEKLARATË**

UNË \_\_\_\_\_ DEKLAROJ SE JAM I INFORMUAR DHE KAM KUPTUAR PARIMET E PROGRAMIT TË METADONIT.

PO ASHTU PAJTOHEM QE T'I NËNSHTROHEM RREGULLAVE TË PARAPARA NË KËTË KONTRATË.

JAM I VETËDIJSHËM PËR PROGRAMIN E MMT-se DHE ME KERKESËN TIME VULLNËTARISHT PRANOJ QË TË FILLOJ TRETMANIN NË KËTË PROGRAM.

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi

\_\_\_\_\_  
Data